

Prof.Asoc.Lindita Milo(Lati)-Kryetare



Lindita MILO(LATI) është Kryetare e Komisionit të Autoritetit të Konkurrencës që nga muaji korrik i vitit 2006. Ajo mban titullin shkencor profesor i asociuar që nga viti 2004 dhe Ph.D. në Ekonomiks nga “Staffordshire University” në Britaninë e Madhe.

Më parë se të emërohej nga Kuvendi si Kryetare e Autoritetit të Konkurrencës, znj. Milo(Lati) ka qenë zëvendës Rektore e Universitetit të Tiranës për periudhën 2004-2006, ndërsa që nga viti 1990 e në vazhdim është Lektore pranë departamentit financë-kontabilitet, në Fakultetin Ekonomik – Universiteti i Tiranës si në nivel Universitar ashtu edhe pasuniversitar. Ajo ka punuar si drejtore ekzekutive e programit Master in Business Administration – Fakulteti Ekonomik, Universiteti i Tiranës në bashkëpunim me Universitetin e Nebraskës, si dhe Bashkëpunëtoreshë jashtme me Institutin e Ekspertëve Kontabël të Autorizuar (IEKA) etj. Gjithashtu Znj. Milo (Lati) është anëtare e Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit që nga muaji mars 2004. Më parë ka punuar si trajnuese në Programin e USAID për komunitetin e infrastrukturës dhe të shërbimeve të kontabilitetit në Kosovë.

Znj. Milo është kualifikuar në mënyrë të vazhdueshme në institucione prestigjioze kombëtare dhe ndërkombëtare në fushën e ekonomisë, financës dhe administrimit të arsimit të lartë.

Znj. Milo është autore dhe bashkautore e disa teksteve mësimore universitare, si dhe shumë monografive, artikujve shkencorë e prezantimeve publikuar në revista e buletine brenda vendit si dhe në nivel rajonal e ndërkombëtar në fushat e kontabilitetit, ristrukturimit e të qeverisjes së kompanive, transfertave të emigrantëve, ndërmarrjeve të vogla e të mesme etj.